



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ministri

Nr. 9394 / Prot.

Tiranë, më 27.10.2014

RREGULLORE
PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË PLANIFIKUARA PËR BLERJEN E LIBRAVE PËR
BIBLIOTEKAT E SHKOLLAVE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

I. Ndarja e fondit për bibliotekat shkollore:

1. Drejtoria e Financave në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, detajon buxhetin në zërin "Shpenzime për krijim fondi biblioteke" për çdo DAR/ZA, sipas formulës "Nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor".
2. DAR/ZA-ja mban për bibliotekën e saj 1% të fondit përkatës.
3. DAR/ZA-ja detajon për çdo shkollë pjesën tjetër të fondit sipas formulës "Nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor".
4. Shkolla ka të drejtë të shpenzojë jo më shumë se 15% të fondit të vet për libra profesionalë për personelin e shkollës. Pjesa tjetër e fondit të shkollës shpenzohet për libra për nxënësit.

II. Kushtet që shkolla të përfitojë nga fondi për bibliotekat shkollore:

1. Përfitojnë nga fondi për bibliotekat shkollore vetëm shkollat publike të sistemit arsimor parauniversitar, që kanë mjedise të veçanta dhe të sigurta për bibliotekë.
2. Drejtori i DAR/ZA-së detajon fondin e dhënë nga MAS dhe njofton me shkrim drejtorin e shkollës që nuk përfiton nga fondi, duke qartësuar shkaku e këtij vendimi.

III. Llojet e librave që DAR/ZA-ja dhe shkolla mund të porosisë:

1. DAR/ZA-ja shpall porosinë sipas listës së librave që ka bërë publike MAS dhe afërsisht porosive që kanë dhënë shkollat.
2. Porosia e shkollave bazohet te lista e bërë publike nga MAS dhe te fondi i vënë në dispozicion të tyre.
3. DAR/ZA-të dhe drejtorët e shkollave, në porosinë e tyre, bazohen në këtë renditje prioritesh:
 - a) Libra të autorëve të shquar të vendit dhe të huaj.
 - b) Libra të autorëve shqiptarë fitues të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
 - c) Libra që shërbejnë si literaturë ndihmëse për nxënësit, për përvetësimin e programit mësimor të lëndëve që përmban plani mësimor.
 - d) Libra që ndihmojnë nxënësit në veprimtaritë e rretheve shkencore të të gjitha lëndëve dhe ato jashtëshkollore, si konkurse, olimpiada të niveleve të ndryshme dhe veprimtari të tjera të ngjashme me to.

- e) Libra që u shërbejnë mësuesve si literaturë ndihmëse në procesin e përgatitjes dhe kualifikimit të vazhduar.

IV. Porositja e librave nga shkollat:

1. Komisioni lëndor i shkollës, nga shqyrtimi i listës së MAS, harton sipas fondit që i është vënë në dispozicion shkollës dhe prioriteteve të mësipërme, listën e librave të kërkuar dhe ia përcjell këtë listë komisionit qendror të shkollës.
2. Komisioni qendror i shkollës, që kryesohet nga drejtori i shkollës, harton listën e librave të kërkuar, në varësi të fondit që i është akorduar, kërkesave të komisioneve lëndore dhe prioriteteve të vendosura më sipër. Kjo porosi i dërgohet DAR/ZA-së.
3. DAR/ZA-ja realizon procedurat e prokurimit për librat e bibliotekave të shkollave në varësi të fondit të akorduar, të kërkesës së shkollave dhe të prioriteteve të vendosura më lart, sipas procedurave të prokurimit në zbatim të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
4. DAR/ZA-ja furnizon secilin institucion arsimor me librat e porositur.
5. Administrimi dhe ruajtja e këtyre librave do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

LINDITA NIKOLLA



MINISTËR

